LIGJ
Nr.7625, datë 20.10.1992

PËR NJËSITË E MATJES DHE KONTROLLIN E MJETEVE MATËSE (METROLOGJINË)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
NJESITË LIGJORE TË MATJES

Neni 1

1. Njësitë ligjore të matjes në Republikën e Shqipërisë janë:
a) Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të dhëna në nenin 2;
b) njësitë e rrjedhura SI;
c) njësitë e pavarura nga SI;
ç) shumëfishat e nënfishat dhjetore të njësive SI.
2. Këshilli i Ministrave nxjerr dispozita të veçanta për njësitë ligjore të matjes.

Neni 2

Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive janë:

Madhësia	Emërtimi	Simboli
Gjatësia	metër	m
Masa	kilogram	kg
Koha	sekondë	s
Intensiteti i rrymës elektrike	amper	A
Temperatura termodinamike	kelvin	K
Sasia e lëndës	mol	mol
Intensiteti i dritës	kandele	cd

Neni 3

1. Përcaktimi i njësive ligjore është i detyrueshëm:
a) Për shkallëzimin dhe tregimet plotësuese për mjetet matëse që përdoren në tregëti, shpërndarje, shërbime, shëndetësi, higjienë, sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet;
b) Në tregti, në shpërndarje dhe në shërbime;
c) Në aktet ligjore e nënligjore, kontratat, njoftimet, informacionet, në të gjitha aktet e tjera zyrtare, si dhe në tekstet shkollore që përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Përdorimi i njësive ligjore nuk është i detyrueshëm:
a) Për kontratat, që kanë për objekt pasuritë e patundshme që ndodhen jashtë shtetit, si dhe për mallrat ose shërbimet e përcaktuara për jashtë shtetit;
b) Për aktet dhe mallrat, për të cilat marrëveshjet ndërkombëtare përcaktojnë përdorimin e njësive të tjera;
c) Për blerjen dhe përdorimin e materialeve ushtarake;
ç) për tregimin e kohës sipas kalendarit.

KREU II
ORGANI SHTETËROR I KONTROLLIT PËR METROLOGJINE

Neni 4

Krijohet Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, si organ i specializuar i kontrollit për metrologjinë në vartësi të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit është person juridik dhe e ka qendrën e saj në kryeqytet. Ajo ka në vartësi të saj degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe.

Neni 6

Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit ka këto detyra e të drejta:

a) përgatit legjislacionin për metrologjinë;

b) kontrollon dhe përgjigjet për zbatimin e ligjshmërisë për metrologjinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) nxjerr dhe miraton udhëzime metodike për përkufizimin, vlerësimin dhe transmetimin e njësive të matjes të madhësive fizike, si dhe përcakton afatet e detyrueshme për verifikimin periodik të mjeteve matëse që përdoren sipas pikave "a" dhe "b" të nenit 11 të këtij ligji;

ç) përcakton saktësinë e mjaftueshme për njësitë e matjes, organizon transmetimin e tyre dhe kryen studime tekniko- shkencore;

d) kontrollon mjetet matëse dhe vendos në lidhje me miratimin, verifikimin dhe kalibrimin e tyre;

dh) udhëzon, kontrollon dhe kualifikon personelin e kontrollit të mjeteve matëse të sistemit të saj dhe verifikon e kalibron bazën e tyre etalonuese;

e) kryen brenda mundësive të saj verifikime dhe kalibrime për të tretë;

ë) në laboratorët e saj siguron dhe ruan në kushte të përshtatshme bazën etalonuese kombëtare të njësive të matjes në përputhje me nevojat e vendit; garanton saktësinë e tyre, duke i krahasuar periodikisht me etalonet ndërkombëtare në institucionet përkatëse jashtë shtetit;

f) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore, si dhe në vende dhe në organizata të tjera ndërkombëtare për problemet e metrologjisë e të kalibrimit.

Mban lidhje të drejtpërdrejta me organizatat ndërkombëtare ose organizma të vendeve të tjera, si dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe a shumëpalëshe për probleme të metrologjisë e të kalibrimit;

g) ushtron kontrolle teknike për saktësi matjeje në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;

gj) autorizon me shkrim laboratorët e tjerë të ushtrojnë detyrën e verifikimit e të kalibrimit të mjeteve matëse ose të etaloneve të njësive të matjes;

h) jep ndihmë teknike dhe merr pjesë në ekspertiza shtetërore ose private për probleme të metrologjisë;

i) cakton tarifat e pagesave për të gjitha llojet e shërbimeve që kryen vetë ose degët e saj në rrethe;

j) cakton vulat teknike të degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse të rretheve dhe merr masa për t'i pajisur me to;

k) krijon këshillin e saj të metrologjisë.

Neni 7

Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë për Drejtorinë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit është i gjithë teritori i Republikës së Shqipërisë; për degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse të rretheve është teritori i rrethit përkatës; ndërsa për punonjësit e degëve përcaktohet nga vetë dega.

Neni 8

1) Kompletimi me mjedise, makineri, pajisje, fond page etj. i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit bëhet në përputhje me mundësitë që ka shteti. Shpenzimet mbulohen nga të ardhurat që krijon vetë kjo drejtori e degët e saj në rrethe dhe nga buxheti i shtetit.

2) Këshilli i Ministrave me propozimin e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit, për verifikimet dhe kalibrimet që nuk i kryen dot vetë kjo drejtori, përcakton laboratorë të tjerë kontrolli ose institute.

Neni 9

Punonjësit e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe të degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe, brenda juridksionit të tyre, kanë të drejtë për t'u informuar dhe për të hyrë lirisht e pa pagesë në objektet që do t'i nënshtrohen kontrollit.

KREU III
KONTROLLI I MJETEVE MATËSE

Neni 10

Mjete matëse quhen aparatet, instrumentet e pajisjet matëse e ndihmëse të çdo lloji, që shërbejnë për përcaktimin e vlerave të madhësive fizike.

Neni 11

1. Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat metrologjike të mjeteve matëse, kryesisht të atyre që përdoren:

a) në tregti, në shpërndarje dhe në shërbime;

b) në sektorët e shëndetësisë, të higjenës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së ambientit nga ndotjet.

2. Mjetet matëse, që përdoren sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen verifikimit para vënies së tyre në përdorim, si dhe miratimit para prodhimit të tyre.

3. Mjetet matëse që përdoren sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, vulosen pas çdo verifikimi e kalibrimi.

4. Personat fizikë a juridikë, që përdorin mjetet matëse të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, duhet të sigurohen që është dhënë miratimi për prodhimin e tyre dhe që është kryer verifikimi brenda afateve të caktuara.

Neni 12

1. Kampionët e rinj të mjeteve matëse që prodhohen brenda vendit, si dhe kërkesat metrologjike të tyre, miratohen nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit.

2. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit bën njohjen e miratimeve, të verifikimeve e të kalibrimeve të kryera jashtë shtetit, si dhe lejon përdorimin e mjeteve matëse të importuara që përdoren në sektorët që përfshihen në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 13

1. Regjistrimin, veerifikimin dhe kalibrimin e mjeteve matëse, si dhe kontrollin e tregimit të sasisë në sektorët që përfshihen në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji, e kryejnë degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe.

2. Degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe ushtrojnë kontrolle çdo vit, për të verifikuar nëse gjendja e mjeteve matëse në përdorim është në pëputhje me ato të regjistruarat dhe

për çdo rast marrin masat përkatëse.

3. Kur u kërkohet, degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe, kryejnë asistencë teknike ose marrin pjesë në ekspertiza të metrologjisë.

Neni 14

Personat fizikë a juridikë që vënë në përdorim mjete matëse për qëllime tregtimi, shpërndarjeje, shërbimi (komunal, shëndetësi, etj.), sigurimi teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet, detyrohen të bëjnë regjistrimin, verifikimin dhe kalibrimin e tyre në degët e kontrollit të kalibrimit të mjeteve matëse të juridiksionit që i përfshin. Gjithashtu këta detyrohen të bëjnë edhe verifikimin ose kalibrimin periodik të mjeteve matëse sipas afateve që caktohen nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit.

Neni 15

Personat fizikë a juridikë, që kanë në përdorim mjete matëse, janë të detyruar t'i kontrollojnë ato nëse janë të rregullta dhe, në rast të kundërt, marrin masa për rregullimin e tyre. Pas çdo riparimi këta detyrohen të njoftojnë menjëherë në degën e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse ku është bërë regjistrimi, për të bërë riverifikimin dhe rikalibrimin e tyre.

Neni 16

Mjetet matëse i nënshtrohen një tarife regjistrimi, si dhe pagesës së verifikimit a kalibrimit fillestar ose periodik. Gjithashtu kryhet pagesa për çdo riverifikim ose rikalibrim. Tarifat për shërbimet e mësipërme miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 17

1. Personat fizikë a juridikë që ushtrojnë veprimtari në tregti dhe në shpërndarje mallrash, ose në shërbimet e matshme, janë të detyruar të tregojnë sasinë e ofruar në njësi ligjore.

Në rastin e furnizimeve të mallrave të matshme si dhe të punimeve e shërbimeve të matshme masa e tyre duhet të tregohet në çdo pako, ambalazh ose shërebim.

2. Personat fizikë a juridikë, që shesin për konsumatorët mallra rinfuzo ose të paraambalazhuara dhe që kryejnë shërbime të matshme, detyrohen të tregojnë sasinë. Me konsumator do të kuptohet cilido person fizik a juridik që blen mallra për t'i punuar, transformuar a për t'ua rishitur të tretëve.

3. Pakot ose ambalazhet të kenë mbishkrime të qarta për sasinë dhe të jenë të tilla që të mos lejojnë gabime në lidhje me sasinë që përmbajnë.

Neni 18

Ndalohet prodhimi i mjeteve matëse pa miratimin nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit.

Neni 19

Mjetet matëse, të cilat gjatë kontrollit nuk rezultojnë në rregull, hiqen menjëherë nga përdorimi, duke iu prishur vulosja.

Neni 20

Pakot ose ambalazhet, përmbajtja në sasi e të cilave gjatë kontrollit nuk përputhet me mbishkrimet, bllokohen menjëherë dhe ndalohet shpërndarja e tyre.

KREU IV
SANKSIONET

Neni 21

Janë kundërvajtje administrative, kur nuk përbëjnë vepra penale:

a) përdorimi i njësive joligjore të matjes;

b) prodhimi oe përdorimi i mjeteve matëse të pamiratuara;

c) shpërndarja e mjeteve matëse të pasakta nga prodhimi dhe nga riparimi;

ç) moskryerja e kontrollit dhe e verifikimit të mjeteve matëse dhe të etaloneve të njësive matëse;

d) mosregjistrimi i mjeteve matëse në degët e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matës në rrethe;

dh) përdorimi i mjeteve matëse nën kufirin minimal dhe mbi kufirin maksimal të lejuar;

e) përdorimi i mjeteve matëse të pasakta që kalojnë kufijtë e shmangieve të lejuara me akte ligjore e nënligjore;

ë) përdorimi i mjeteve matëse që u mungon dokumenti dhe vula e kontrollit mbi mjetin matës;

f) përdorimi i mjeteve matëse që u ka kaluar afati i kontrollit;

g) dhënia mangët në tregti, ose në shpërndarje a shërbime;

gj) ndërhyrja ose falsifikimi në mjetin matës të verifikuar ose të kalibruar;

h) mosvënia e mbishkrimit të sasisë, sipas kërkesave të nenit 17 të këtij ligji;

i) tregtimi i mallrave të ambalazhuara ose të paraambalazhuara, sasia e të cilëve nuk është në përputhje me mbishkrimet.

Neni 22

1. Personat fizikë a juridikë që kryejnë kundërvajtje administrative, në rastin e parë, dënohen me gjobë nga 500 deri në 10.000 nga punonjësit e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe të degëve të saj në rrethe. Në rast përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje dënohen me dyfishin e kësaj gjobe.

Neni 23

Organet e tjera që caktohen me ligj për të ushtruar kontroll për zbatimin e neneve të veçanta të këtij ligji, mund të japin dënime në bazë të kompetencave që u janë dhënë me ligj, vetëm për kundërvajtjet e nenit 21, shkronjat "ë", "g", "h" dhe "i" të këtij ligji.

Neni 24

1. Kundër vendimit të dënimit të dhënë nga punonjësit e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, si dhe nga kryetarët e degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe, mund të bëhet ankim te drejtori i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, akti i të cilit është i formës së prerë.

2. Kundër vendimit të dhënë nga punonjësit e degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe mund të bëhet ankim te kryetari i degës së kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse të rrethit përkatës, akti i të cilit është i formës së prerë.

3. Ankimi mund të bëhet brenda 15 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të dënimit.

Neni 25

Gjoba përbën titull ekzekutiv.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Dekreti nr. 6856, datë 24.1.1984, dekreti nr.7268, datë 12.12.1988, si dhe dispozitat e tjera ligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.342, datë 4.11.1992 të Presidentit të Republkës së Shqipërisë, Sali Berisha.